




SHKATĚÄRO
DIS-TEM-ÄIN







QUEER



Parathënie

Politika e poezisë: Një koleksion kolektiv ëndrrash për të luftuar izolimin.

Nga Kristi Pinderi

Emrin e Ilir Belliut e dëgjova për herë të parë në redaksinë e gazetës Shekulli ku punoja si redaktor, në vitin 2011.

Elsa Demo, e cila mbulonte faqet e kulturës në gazetë, mbante një bllok shënimesh, ku shkruante ide për shkrime të ndryshme. “Po mendoj të shkruaj për Ilir Belliun,” tha duke nxjerrë nga çanta bllokun e saj. “Nuk di në e njeh, është një poet gej,” shtoi pastaj duke hetuar me kujdes reagimin tim.

Ato kohë, edhe pse unë nuk e kisha treguar haptazi orientimin tim seksual, më dukej sikur të gjithë e dinin. Elsa po e po, ngaqë më herët kishim biseduar për Festivalin për të Drejtat e Njeriut që organizonte Kujtim Cashku e ku Elsa kishte punuar si këshilltare për komunikimin. “Nuk e njoh,” i thashë.

Ajo iku ndërsa unë u ula të kërkoj në internet emrin që ajo sapo më kishte përmendur. Nga ato pak rezultate kërkimi zbulova diçka befasuese. Vargu i Ilirit - një poet i viteve të para '90-të, për të cilin Agron Tufa shkruante në revistën “E Përshtatshme” të Hervin Hatibit se ishte “avangardist”, me një jetë si një “udhëzë të shkurtër flakërimi dhe shuarjeje, sikundër se është udha e djegies së një me-teori gjer sa shuhet në gji të dheut”, - më dukej sa i re, po aq edhe familjar:

*Pushtojmë pa dashur njëri-tjetrin,
e më pranë vetes mbesim!
Si unazë më rri në gisht
Ky qytetth i egër. E më trisht.*

*E pat dhe kjo aromë,
Që çmeriti një plak të njomë...
Eremit qëlloi ky klient i Etjes,
Që rilind festiv nga mitra e vdekjes.
Pushtojmë padashur njëri-tjetrin,
E më pranë vetes mbesim...*

Ajo që shumë vetëve mund t'u duket si varg hermetik, kuptimi i të cilit mund të dekodohet vetëm nëse ke "çelësin" e duhur kuptimor, për shumë prej nesh mund të jetë një déjà vu. "Si unazë më rri në gisht/Ky qytetth i egër", është ndoshta metafora më përbashkuese për betejat vetmitare që disa prej nesh bëjnë me shoqërinë përjashtuese ku jetojmë, beteja që mund t'i luftojmë vetëm nëse e transformojmë apo e fshehim veten, duke u bërë kështu ose të padukshëm, ose hermetikë të mbështjellë nga një guackë e patejkalueshme nga asnjë vesh a sy paragjykues.

Kjo temë e fshehtësisë, e izolimit të kujdesshëm shpirtëror në ëndërr a në dhoma të zakonshme të qyteteve të "egra" ku jetojmë, është në fakt një temë e rrahur boll edhe në poezitë që do të lexoni në këtë botim.

"I myll n'kët dhom me ty du me ngec/as drit s'du, më mjafton shikimi jot"- Anonim

"Në carcafët e mëndafshtë/Sonte në këtë dhomë/Vjën aromë lulesh", shkruan Keo Qerama.

Pak rëndësi ka nëse muret e dhomave të fshehta janë imagjinare apo referenca të hapësirave fizike të vetmisë. Ato mbeten sinonime të një hapësire që dhe pse të mbyllura, mund të garantojnë një lloj lirie që buron nga nje sens relativ sigurie. Si në poezinë e Anonim 8773: *"Shkelmo kater muret/ne te cilat arratise mendjen/kur kishte nevoje per pak qetesi."*

Por këto mure që na mbrojnë nga bota përjashtuese jo gjithmonë janë një oaz qetësie. Qetësia shndërrohet në një gjëndje permanente trishtimi e mungese shprese aq sa njeriu rresht së jetuari deri ditën kur ndërgjegjësohet sa shumë kohë e çmuar ka kaluar. Në poezinë "Errësirë", për shembull, dhoma (ose sekreti) që për dikë është simbol i një guacke që lejon lulëzimin e patrazuar të dashurisë së penguar, për dikë tjetër kthehet në kotësinë torturuese që vetëm errësira mund të prodhojë: *"U linda bashkë me errësirën/a ndodhta errësira lindi me mua"*, nis ajo poezi.

Sa ishte gjallë, Ilir Belliu botoi vetëm një libër të titulluar *"Vetmi me njerëz"*. Në rrethet e ngushta letrare të Tiranës kaotike të viteve 90-të seksualiteti i Ilirit ishte shpesh objekt bisedash por aksund nuk thuhet ndonjë gjë për këtë fakt, ndaj vëllimi i vet poetik është ndoshta testamenti më monumental në letrat shqipe për izolimin e komunitetit "queer" dhe për fshirjen totale të këtij komuniteti nga hapësira publike.

Ky izolim i tipit *"flasim për poezinë, por jo ama për identitetin e poetit"* vazhdoi edhe pas vdekjes. Askund nuk shkruhet as edhe një rresht se si mund të jetonte një poet 'queer' në vitet 90-të në Shqipëri. Unë nuk kam mundur të mësoj edhe sot e kësaj dite, ndonëse jam përpjekur shumë, se si vdiq Belliu në vitin 2001 dhe si u gjet pa jetë në malin e Dajtit. Askush nuk ka guxuar ta lidhë emrin e Ilir Belliut me seksualitetin apo identitetin e vet gjinor qoftë edhe njëherë publikisht, sikur ky konspiracion sekreti të ishte një mallkim që do duhet të shoqërontë dikë edhe pas vdekjes.

Ilir Belliu dhe vepra e tij është e përfshirë në vëllimin *"Albanian Literature: A short history"*, nga Robert Elsie. Ky është një konfirmim i hidhur dhe i ëmbël njëkohësisht i vendit të padiskutueshëm që Belliu ze jo vetëm në historinë e letërsisë shqipe, por dhe në historinë e individëve 'queer' jeta e vepra e të cilëve është dokumentuar nga Elsie, edhe ky një pjesëtar i komunitetit 'queer' që ndonëse i dha aq shumë albanologjisë shqiptare nuk guxoi kurrë të fliste publikisht për seksualitetin e vet. Të ketë menduar se ky fakt mund

ta bënte më pak të pranueshëm punën e tij në sytë e shqiptarëve të cilët e kanë më kollaj të të pranojnë kur e praktikon me fanatizëm konspiracionin e fshehtësisë?

Ajo që dua të them është që historia jonë kolektive është e mbushur me akte të tilla vetmitare shpëtimi. Izolimi apo kamuflimi mund të ketë qenë për shumë prej pjestarëve të komunitetit tonë i vetmi akt rezistence. Mirëpo ne që jetojmë sot në një shoqëri relativisht më të çliruar, të jemi të ndërgjegjshëm dhe të jemi në dijeni të historisë sonë, është si një prerekuzit që na ndihmon të ecim përpara.

Ndaj pikërisht për shkak se ne jemi të ndërgjegjshëm dhe të aftë për ta zbuluar dhe shpluhurosur historinë tonë, jemi më në fund gati të bëjmë një akt të mëtejshëm rezistence. Teksa individë si Iliri e luftuan përjashtimin shoqëror përmes poezisë së vrullshme, ose lakonike e shpesh vetmitare, sot ne bashkarisht po bëjmë një hap më tej. Ne po shembim një nga një muret tona të burgosjes shpirtërore dhe identitare dhe po bashkojmë njëri tjetrin përmes poezisë. Ky libër, kjo përmbledhje e parë poetike, është kështu një akt i mirëfilltë politik dhe një përpjekje kolektive për ta projektuar veten në një koleksion ëndrrash që respektojnë të sotmen dhe lartësojnë edhe të shkuarën tonë të mohuar. Vetëm kështu, vargje si këto më poshtë të Belliut marrin kuptim:

*Brenda teje gjithë zogjtë e botës këndojnë
Dhe askujt nuk i shkon ndërmend
Se aty jepen koncerte.*



IMAZHI IM

TI O DET

ME HUPË N'TY

CELIN LULET

GJITHÇKA PËRFUNDON ME NI PUTHJE

**PO NESËR, ÇKA?
PIK' PIK' PIK'**

MURET E FATIT

ME TY

ANARKIA

ERRËSIRË

CELIN LULET



NËN GJINJTË

SI SAFO

DON ZHUANE

MOS VALLË ENDE PËR VIRGJËRINE KAM MALL?

DUA TË JEM LIBËR

E NDALUAR

ZGJEDH TË DUA VETEN

DASMA

HOMOSEKSUALITETI (HOMOFOBIA)

E KE HUMBUR DREJTIMIN...

UNGJILLI I PALIT

NË EMËR TË DASHURISË

KUJTIMI I FUNDIT

SEKONDA

NË KËRKIM...

I WANT YOU LIKE THE NOISE IN MY HEAD

FJALË SHPIRTI

TRISHTIM

NJË FUSTAN, I VOGËL, I ZI

ISO

PREKJE E MALLKUAR E BUTË

SHKELMA

PRAPË

AJO





QËLLO I QARTË

NDJENJË HYJNORE

VETVETJA

Ç'TË TË THEM MË PARË, GJYSH...

UJI I FTOHTË I DUSHIT MA PËRSHKOI LËKURËN E KOKËS DHE TRUPIN.

MARRJA E SHPISË

DREJT ASGJËKUNDIT

ORGJI SHEKULLORE

VIOLINA E ARTË

DREJT ASGJËKUNDIT

JASHTË KUTISË

TANI JAM DAVIDI

Pik' Pik' Pik'

Pik' pik' pik'
po m'pikojnë hapat e tu nëpër qiell
se n'tokë s'po ekziston ma për mu
me mall e me gëzim n'andërr po t'shoh përher'
shpesh jam përpjekë me t'përqafu.

Të ftohta po t'i ndjej gjymtyrët
dhe pse n'andërr zor se ndjen ftoht'
për herë t'fundit tentoj me t'i puthë syt'
pa m'than' 'të du' t'lutna mos shko.

-Anonim

Me ty

Edhe sonte porsi dje
mos ngurro me m'puthë fort
s'baj asgja tjetër veçse shkel
n'këtë tokë gri, zvarritem me zor.

Prapë orët e vona t'natës po i pres
si t'shenjta po i trajtoj
i mbyllun n'këtë dhomë me ty du me ngecë
as dritë s'du, më mjafton shikimi jot.

Brishtë e lehtë
lëkurën po ta prekë
ndjesi e artë'
si fmija kur balonën ndjekë.

Ti po m'shijon ma shumë se kanga
po m'shijon ma shumë se ky diell
shija jote porsi andrra
që e kam andrru përher'.

-Anonim

Ti o det

Po notoj në ujëra të trazuara
forcat shterrojnë, vështroj qiellin
ti o det, fike diellin.

Më ndalo, më shpëto
më shiko, më ledhato
si dikur, më zbukuro.

Të dorëzohem?
unë nuk di!
Çelësin e mban në dorë ti
gojën ma mbyllin, rrethanat dhe koha.

Më shpëto, më jep frymë!
Toni gri, harmonizo!
si dikur më miklo.

Ti je det i trazuar
valë e fjalë, i shkumëzuar!
Klithmoj fort, jam në ankth.

Merrmë pranë, më fol!
më dëgjo, a më do?
si dikur, më përjeto!

Merrmë pranë, më fol!
më dëgjo, a më do?
si dikur, më përjeto!

Çdo buzëqeshje, është shëmtuar
ti o det i mallkuar!
notoj fort, do gjej shpëtim.

Nuk ka shpjegim, vetëm zhgënjim.

Shpirti im, është jetim
por jo viktimë, nuk jam flijim!

Notoj në ujëra të trazuara, krejt momentet e kaluara,
janë valë të tërbuara.

Përjetoj, nuk është gabim,
e drejta ime është shpirti im,
se gjithmonë, ka shpëtim!

-Roni Klein

Po nesër, çka?

Sonte du me ken ni poet,
Nga ata t'çmenmit,
Që hedhin n'letra zhgarravina
T'frymzume prej gotes me ven që majn maj libra
Zhgarravina që si kuptojnë as vet,
E mrapa njerzia e ban poet.

Sonte du me ken ni zyrtar
Ni njeri me pozitë,
Që munet me bertitë, me sha, me thy
E mos me gjyku kërkush
Sonte du me kon askushi
Që me e lan t'qetë qenjen teme.

Sonte du me ken ni pijanec,
Që endet rrugëve,
E se vret trunin me pytjen retorike
“Po nesër, çka?”.

E un sonte jam, sdi se çka,
S'di me dhanë emër kresës që kam formu n'mu
Sonte jam veç unë,
Noshta edhe ni fllad i lehtë,
Edhe do menime zuska që po më përdhunojnë trunin.

...

Tpakten s'qenkam vet.

-Medusa

Gjithçka përfundon me ni puthje

Gjithçka përfundon me ni puthje
Puthje e mrapa në fund.
Puthje t'vdekmish kishin ken.
Që smujtën
me majt gjall kraharorin e saj,
Qoftë edhe për ni ditë,
Puthje ma t'heshtuna se vdekja.
Që amel, qetë, pa u nigju,
Vijshin e merrshin diçka mrena saj.
E puthjet fantazma e bajshin me u ndje bosh,
Po ajo prapë donte me u ndje e puthme...

Gjithçka përfundon me ni puthje
Edhe andrrat e saja.
Po masi ato andrra ikshin,
Ajo thurte andrra t'tjera.
Se n'fund t'fundit,
Këtë dinte
ta bante ma s'miri.

Me andrru...

-Medusa

Me hupë n'ty

Noshta edhe perënditë
Do ishin ken xheloze.
Se trupi i saj lëvizte
Thu ajo ishte rritë me detin.
Thu kish hedhë shtat me valët.
Thu ish rritë n'guaska...

E tash n'menjen teme
Ke ngelë si ni aromë e lehtë.
Ni mister i bukur,
Që me durt e mija kisha dasht me t'zbulu.
dhe pse kam frikë.
Noshta me durt e mija t'ndyta

T'prishi.
Ta hupi erën,
Ta hupi misterin,
Ta hupi bukurinë e shtatit.
E un se du kurrsesi këtë gja.
Kam frikë se...

Noshta unë dehem mas teje
Hupi

Mas erës tane,
Mas misterit tan,
Mas bukurisë s'shtatit.
E un s'du kurrsesi me hupë veten.
Edhe pse me hupë n'ty
Ja kish vlejti'.

-Medusa

Vetvetja

Po, Unë e pranoj
Dhe përqafoj veten time,
Pa paragjykime.

Po, Unë e dua
Dhe e respektoj veten time,
Për ashtu siç jam.

Po, Unë e vlerësoj
Dhe e nderoj veten time,
Për atë që jam.

-Shukri Kastrati

Ndjenjë Hyjnore

Aroma e tij
Zemrën time zmadhon
E adhuroj shikimin
Kur ai më ledhaton
Butësia e tij
Shpirtin tim ndriçon
E ndjej dashurinë
Kur ai më përqafton
Qeshja e tij
Qenien time lumturon
E shijoj gëzimin
Kur ai më shtrëngon
Prekja e tij
Trupin tim rigjallëron
E dua rënkimin
Kur ai më kafshon
Nxehësia e tij.

-Shukri Kastrati

Qëlllo i qartë

Sa të çmueshëm
Ne jemi pa çmim
Thesar të botës
Pa asnjë dyshim
Ishim, jemi dhe po
Do jemi përgjithmonë
Ajo ngjyra krijuese
Për gjithë jetën tonë
Se njerëzit kërkojnë
Përpiqen e synojnë
Me vullnet syndritur
Kur ne përparojmë
Por natyra lulëzon
Edhe pse paragjykojmë
Ato yjet shkëlqejnë
Kur ne dashurojmë.
Pra pastër rezisto e rrezato
Se ti luan një rol të caktuar
Kur je në një rreth të pacaktuar
Ti arrij e vë cak, zë cak, rri cak
Dhe qëllim mirë do jesh i shquar
Pra qartëso para se qëlluar.

-Shukri Kastrati

(Pa titull)

Dreqi i marrtë yjet dhe natën
formula makabre që të kallin datën
datën e lindjes dhe datën e vdekjes
pengje prej yjesh që zhbëhen prej tretjes.

S'ju mbajti dot Zoti dhe ju derdhi në qiell,
s'ju duroi as Dielli,
ju errësoi në terr.

nuk ju mban as Hëna...dritën ju kursen,
ju mbajti njeriu, një qenie që flen.

-Luana

Anarkia

Një shi prej shkarravinash
si rrebesh ra mbi letrën e shpirtit tim,
analfabetizmi i penës me vrull
filloi të endte trishtim.

Stuhitë e gërmave nuk gjenin dot rend,
si qymyre fjalësh u mpleksën pa vend.

Nuk kishte as pika nuk kishte as presje
U shurdhuan fjalët na humbën dhe shprehjet

Nuk kishim zë për të kënduar fjalët,
nuk kishim as det për të rënduar valët,
batica me alegori përmbytin fletët,
dhe kuptimi si një Noe, thurte fatin me hoje bletësh.

Me hoje prej bashkëtingëlloresh...
e me mjaltë zanoresh,
ku keqkuptimet lindin centaure prej shprehish
dhe vargu më pas kthehej në një ciklon stuhish!

-Luana

Muret e fatit

Po vrasim kohën duke pritur
Në heshtje imazhet e vdekura
Të jetës së painteligjente.

Nata të falë afshin e dashurisë.

Në çarçafët e mëndafshhtë
Sonte në këtë dhomë
Vjen aromë lulesh,
Ndoshta ngaqë ty dashuria ime
të quajnë lule.

Një lulëkuqe si virgjëria e saj,
Në ëndërr trupin ma ledhatoi,
Unë e vetme me dhimbjen time
Zjarrin, mallin për ty vegim
Vetmisë i çoj,
Duke parë në këtë natë hënë
Ja si po e artikuloj këtë natë:

Në taracë, e vetme,
me një batanije,
në sy e shpirt-lot.

-Keo Qerama

(Pa titull)

Ti o yll i rënë nga qielli
Ti që m'a ndeze lumturinë
Ty të besova zemrën
Bashkë me të dhe dashurinë.

S'të kërkova botën
E di që është e madhe
Të kërkova ndjenjën
Që t'i vetë ma fale.

Thoje: Me ty s'vej njeri!
E ja...mbi të shkele ti!
Kaq shpejtë e harrove ti se ç'është dashuria?
Ku tashmë mbi ty ekziston vetmia!

Nuk bëhem xheloz që zgjodhe vetminë
Por unë kam ndjenja për dashurinë....

-Florjan Mulleti

Imazhi im

Imazhi im në pasqyrë,
përse kaq gri, a ke tjetër ngjyrë?
Tani ti je i veshur,
me buzëqeshjen tënde, i zbehur.

Kur të pyes, pse më gënjen?
Ndërsa e djeshmja po të mbërthen.

Kur përgjigjesh, pse nuk tregon?
Për të sotmen, pse s'jeton?

I mbyll sytë, s'dua të t'shoh
E kotë kur s'fsheh dot,
dhe në mendje më ngulitesh.

Imazhi im, në pasqyrë,
nëse je gri, unë të premtoj ngjyrë!

Sot është vështirë, por ama a e di,
që e nesërmja mund të veshë plot me ngazëllim.

Sepse dhe kur shpresa për të sotmen,
duket se është shuar
Të zgjuara janë netët,
nga ëndërrat trazuar
Ndaj këtë Botë,
që rishtas e gjej, e dikur,
përmbi veten,
ylberin e shpërthej.

-Roni Klein

Çelin lulet

Mbill lule n'emnin tem
kur nuk jam ma.
Mbill lule n'varrin tem
ta di sa m'don
t'ja ni erën dashnisë tane,
rrajt e forta.

Mbill lule n'emër t'dashnisë tem,
le ta njohin dashninë që e kam pasë,
dashninë që e kam lanë.

Mbill lule mbi trupin tem.

Mbill lule! Mbilli!

Le ta din' që trupi jem
ma n'fund ka lulëzu.

Mbilli ato lule për dashninë që e kam lanë,
dashninë që e kam jetu.

Mbilli për netët e gjata,
për netët e shkurta.

Mbill lule për g'zim.

G'zimin që e kam njoftë kur e kam pasë n'krah;
kur m'ka pasë n'krah.

Mbill lule ta festoj këtë ditë;
ditën kur e njofta veten,
kur e kam dashtë.

Mbill lule për dashninë;

mbill lule për trup,

për l'kurë, për zemër, për men'je.

Mbill lule për mu.

-Mak

Pellg i plogështisë

Një kupë mbaj në dorë,
përreth me ar të veshur.
krejt çuditshëm po prej saj,
buçet një zë i heshtur,
jehonë shpirti, ndjenjë-simfoni.

Thellë nën kupë vërej,
veten duke vallëzuar.
veçse, jo në një përrua nimfash,
por në pellg të plogët... pellg të përçudnuar...

Helm i tillë prej motesh nuk ish' parë,
e sot, më vihet si theror përpara
më ofrohet si dhuratë e mortshme,
prej atyre...
që vetëm dashuri u fala.

Ta kthej me një frymë, me një frymë të fundit?
(fundja, ç'do të humbja më prej botës?)
Sa të mbytem në një det gjykimesh,
më mirë mbytem në k'të pellg,
tok me një mori kujtimesh,
që s'më lanë tjetër shteg.

S'meritova të më duan,
ndoshtja sjellja i tmerroi,
ndoshta ëndrrat që me ëndje thurja,
egon, smirën,
ua përvëloi.

I lodhur, këmbëzbathur,
pa stoli, me petkun-turp mbi krahë,
rend drejt fatit tim të hidhur,
drejt Ferrit...
me zemrën që ka frikë të rrahë.

Në gëzohen tek atje më shohin,
ta dinë mirë, trumykurit shpellarë,
se dhe flakët madhështinë ma njohin,
e ndër to me hov do t'hidhem,
më në fund i lumtur,
me Asmodeusin në krahë.

- Jonart

Nën gjinjtë

Doja të vendosja “caput”
në mes gjinjve të tu.

E pse të mitë i kam
të tutë doja at’ nat’,
buzëqeshja jote edhe më shumë më çmend.

S’di si munde ti
me mua t’bëje dashuri?

Ama, e gjitha platonike ishte
ti në tjetër shtet
e unë në tjetër vend.

E kur bashkë u njohëm
asgjë nuk bëm,
frikë kishim të dyja
s’dinim si të afroheshim
s’dinim ç’po ndjenim.

Herë e parë
që një vashë në siklet më vë.
Siklet i lezetshëm,
me të vërtetë vështirë
të duash një femër.

Edhe më vështirë një femër
të dojënjë femër tjetër.

-Ina Baqoshi

Si Safo

Epsh femëror, përzier me një epsh
edhe më të zjarrt’
e ky epsh, po nga një femër buron.

Në antikitetet thuhet se
çudi e madhe
buzët me të njëjtën gjini të bashkoje.

Dy femra bashkë?!
Si ka mundësi?!

Trupat bashkëngjiteshin,
Orgazmat krijohen.

Si Safo, ato lodrojnë,
lule më lule,
palmin e tyre të lëshojnë
e bletët nga tutje vinin,
Safon duan të shikojnë
Roza me rozën bashkohet
Dashuri dëshiron të bëjë.

Mish me mish fërkohet,
Fetusin kush do ta krijojë

-Ina Baqoshi

Don Zhuane

Të mos dish ta gëzosh shpirtin, do të thotë ta shesësh.

Thotë Camus për Faustin e më gjerë,
e ndërkohë...

Don Zhuani ka vendosur të jetë një hiç.

Të paktën kështu ka arritur të kuptojë jetën.

Nëse unë jam e aftë të kuptoj se jam askushi,
aty më buron lumturia.

Më besoni!

Më besoni, se unë vet jam një Don Zhuane.

E pse u dashka dashuruar një herë në jetë?!

Një herë që gjasmëe të duash më shumë?

Mashtrime...

Qenia njerëzore është e lirë,
e mund të dashuroj' sa herë të doj'

Don Zhuani i ndërronte gratë,
jo se nuk i donte më,

por sepse secilën e donte me të njëjtën dashuri.

Shpreson nga secila,

t'i jap atë që s'ja dha tjetra.

Don Zhuani nuk trishtohet,

Ai trishtohej vetëm kur shpresonte.

Po tani Don Zhuani di dhe nuk shpreson.

Një mashtrues koshient që e di mirë se ç'e pret.

"Njohja" është akti i dashurisë, thonë të lashtët

E këtë e pranoj e unë.

Ama ai, luftoi kundër një perëndie që nuk ekziston.

E kjo është arritja më e madhe,
E unë më lehtë pranoj se Don Zhuani
I dha fund jetës duke u varrosur në një manastir

Se sa fabulën e "Vërtetë".

Do ishte paradoks Donzhuani.

Unë e përsëris që vet e tillë jam.

Një jetë e tërë e "pushtuar" nga absurdja.

E në më kuptofshit, nder më bënit.

E në jo, nder i bënit vetes suaj.

Se për ju, unë jam poete e huaj!

-Ina Baqoshi

Mos vallë ende për virgjërine kam mall?

Cit. Sapfo frag. 107
E paprekur ende, si mëparë
Të jem unë dua...
emocione të pashkruara
e ndoshta të papërjetuara.
M'janë mërzitur ndjenjat
se të sinqerta më si gjen,
ato janë si era
E cila shkon e vjen.

Virgjëria mu rikthye,
kur sytë e mi bukurinë tënde panë.

Nimfa ime,
bukuria jote s'do më mërzitet
O vashë e hirshme!
O rioshe ngjyrësheshumë!

Himena
U rikthye.
T'largësojmë emotivin
T'shkojmë pro emancipimit.
Himena,
Hiqe timen ti
e unë ta heq ty!
Fjetsh në kraharorin
e shoqes sate të ëmbël!
E në u dashurofshim
Hiret pa turp më trego.

Vashës elegante
që trurin po ma çmënd!
Lule e argjendte
e kopshtit tim!
Athina të ka zili,
E Afërditës i tha të të bëj magji...
Një poete të dashuroje
e me të veç dashuri të përjetoje!
Mua mu duk bekim
N'ditët më të errëta t'shpirtit tim.
*Sapho frag. 126

-Ina Baqoshi

Dua të jem libër

Dua të jem libër,
të më shfletosh ti
dua të jem fletë,
Të të më lexosh e ndër rrjeshta të më shohësh,
në mendje të të kaloj pas çdo shkronje,
morfemë, fjalë, fjali, paragraaf a tekst t'jem
thjeshtëë që të më prekësh ti.

Gishtat të kalosh përmes meje
lehtë dhe me “delikatësi”

Dua të jem libër,
libër që e prek vetëm ti.

Mbamë n'dor'
ruamë nga flakëritja e zjarrit
se shpejtë do të digjem, e di.

Gishtërinjtëët kalojnë ndër rrjeshtat e mi,
teletransportohen tek mendja.

Aty gjendesh ti!

-Ina Baqoshi

E ndaluar

Një ndjenjë e rrallë rehatie
teksa ajo bën hapin e fundit
një fillad i çuditshëm thërret emrin e saj
ajo shikon prapa për herë të fundit.

Gjithë çmenduria, thanë
goditi fort deri në fund
filloi ngadalë por thellësisht rrëshqitur
nuk mund të përzihet më.

Gradualisht të gjitha, por të shpenzuara
çdo ditë më larg nga lumturia
Pse zbuloi ajo vallë
ndjenjat me të cilat ajo ka lindur.

Tani hapi është hedhur
e lidhur në rënie përgjithmonë
ajri i shtyn trupin e saj
i ndalur vetëm nga toka.

-Gentrit

Ungjilli i Palit

Gjuajeni me gurë atë dashuri
Që Zoti vetë e braktisi në altar
Gjuajeni për vdekje e keq të mos të ju vijë
Mos i jepni as varr.

Digjeni në turrë atë pështirësi
Që turpëroi etërit e nënat trishti
Një dashuri shterpë mos e lini kurrsesi
Mbi tokë të lulëzojë.

Pështyjeni, talleni, mallkojeni
Ndoteni me të vjellat e vrerit në bark
E në mëshirë nga ju kërkofte
Goditeni edhe pak.

E kur ta shihni ashtu të vdekur
Qeshni, me etër e nëna bashkë në kor
E Zoti nga lart t'ju derdhë bekimin
Juve, o shenjtorë.

-Bardhi

Homoseksualiteti (Homofobia)

-Nuk është mëkat,
Nuk është një gjë e dënueshme,
Nuk është një arsye për t'u urryer,
Është thjesht diçka që je.

- Disa fëmijë ngacmohen,
Disa dëbohen nga shtëpitë,
Për shkak të të qenit ndryshe,
Disa rrihen gjithashtu.

-Në këtë botë gjykuese,
Nuk ju lejohet të bëni asgjë,
As të diturit e kush je,
Sepse njerëzit nuk interesohen të dëgjojnë.

-E ndryshmjat nuk është e gabuar,
Është thjesht diçka për t'u mësuar,
Dhe njerëzit duhet ta kuptojnë këtë,
Para se të sillen sikur,
Ata dinë gjithçka.

-Drini Dafota

(Pa titull)

Ku e fshehë buzëqeshjen?
Ka kohë që të është larguar nga fytyra...

Ku të shkoi forca?
As kokën nuk po arrin taë ngresh teksa më flet...

Ku e le guximin...?
Të pashë të fshehur pas një muri
lidhur me zinxhirë nga vetë frika jote.

Ku i ke humbur shpresat?
T'i grabiti bota.
Kjo botë boshe që lumturohet vetëm
në urrejte.

Ku e le dashurinë?
Mendove se kaq nuk mjaftonte
për të ta bërë jetën më të mirë
Për të përballur ligësinë e njerëzve?
Po tani që vërtitesh në një zbrazëti të
madhe

Ku e ke zemrën?
As atë nuk e ndjen teksa të rreh nën gjoks?
Ajo në çdo sekondë të jetës të tregon
rrugëtimin.

A e dëgjon?
Po të flet...
E ke humbur drejtimin...
Kjo nuk është rruga jote...

Në atë rrugëtim nuk jam unë!
Nuk je as ti!
Nuk jemi më ne!

E ditën që do arrish të çliroh veten nga
frika e saj...

Ndoshta aty nuk do të jem më unë!
Ngrije kokën ...
Dhe ecim...Bashkë...

Në djallë të shkojë bota,
Në djallë ata që na përqeshën
Në djallë ata që s'na e besuan lumturinë...

Në djallë të shkojë hipokrizia
Në djallë xhelozia se dy njerëz të njëjtë nuk
mund të duhen më shumë se tabuja e krijimit
hyjnor!

Në djallë të shkojë....
Eja kape dorën time
Më ler të jem mburoja jote...
Eja sot... të arratisemi ...
Bashkë...
E nesërmja është vonë!

E nesërmja është vdekje e unit dhe gëzimi i
të tjerëve!

-Eugert A.

Dasma

Dielli djegë defat e dekoruem
të lanë n'çardakun çifligar,
përrjashta presin drunjtë e praruem
qershitë e kuqe me u'a marr'.
Qepin e qëndisin qikat çukaloshe
fustanet e flladshme të verës
njana prej tyne njajt' bukuroshe,
jasht dritares i fol' erës:
"Erë që fryn e fluturon
mbi bjeshkë e male varg,
kah t'ka anda e kur kujton
si ja ban kur mbetesh larg?
Larg luleve lozonjare n'livadhe
ku kaq gjatë ke vallëzue,
nëpër drenea e sorkadhe,
qysh ato me i lëshue?
Po në duan me të marrë
atje ku s'do shkoje kurrë,
shembull, të mbulume n'ar
të të shpien te një burrë?"
"Të mbulofshin me çka t'dojnë,"
erdhi ëmbël zani i njohur:
"Sa jam këtu s'kanë ku t'çojnë,
për këtë Diell që n'a ka ngrohur!"
Jashta dritares, aty priste
ajo që me syt' e zi,
me një shikim sikur e vriste;
i'a digjte zemrën shkrumb e hi.
Ajo që faqet i'a kish' skuqur
si qershit' e oborrit,

buz't e saj e kishin puqur
si të ish' zanë e Tomorrit!
Lulëzonte zemra e saj
kur ishte me dash'noren e vetë;
po i vinte me plas' në vaj
kur kujtonte çka e pret!
Morri n'grykë shoqet një nga një,
e fytyrën e mbuloi;
Hallall, moj shoqe bajani,
se baresha nuse shkoil!
Lag loti sytë me lara,
andej ata festojnë;
nusja në kalë hypi para,
lot e tela i xixëllojnë!
Niset nusja në kalë të bardhë,
Niset nusja në kalë të bardhë,
gjersa në horizont zhduket,
krushqit tashmë kanë ardhë
po nusja e re s'po duket!?
"Qajni krushq e qajni msit',
Këndojnë shoqet buzagas;
me marr nuse keni prit',
veç poget për ju s'ka pas'!"
"Ku asht ajo? Kemi pajë!"
krekoset njani aty,
-Ajo asht nis' me dashninë e saj,
merrnja pajën prapë n'shtëpi!
Të dy dylberet dalë kadal',
kalojnë në vise t'reja,
vetëm ato mbi një kalë;
kështu nis epopeja!

-Diana Dukagjini

Një fustan, i vogël, i zi

Për ditëlindje, i kërkova një fustan, të vogël , të zi
me pika të bardha
ose lule të verdha.
Më shndritën sytë.

-Mami, të lutem, i thashë
Do ta vesh vetëm këtu , në shtëpi!

-Ti je djali ynë, dhe biri im
Kurrë në botë nuk ta blej
Një fustan, të vogël të zi!

Ndoshta me lule ose me pika
S'ka rëndësi,
Ti je një djalë dhe nuk vesh dot,
Një fustan, të vogël, të zi.

-Mami, po të isha vajzë,
Do më blije një fustan të kuq ose të zi?
Do më krahasoje me një lule
Apo me një flutur?

Do më jepje t'i provoja vathët e tua të arta
dhe fustanet e tua të kaltra?

-Mami, unë brenda jam vajzë!
Po edhe nëse nuk mendon se jam
Pse nuk mund të vesh,
Një fustan, të vogël, të zi?

-Aurora

Prapë

Prapë kam mendu me t'puthë sonte
njëjtë si dje, njëjtë si nesër
njëjtë si çdo natë tjetër.

Edhe sonte prapë jam munduar ta fikë dritën e fortë
me të cilën sytë e tu verbuan të mitë në errësi
prapë nuk e kam gjetur çelësin
ajo dritë prapë më ka mbajtur zgjuar,
prapë prej saj e kam gdhirë.

Prapë kam lexuar të njëjtën poemë, të njëjtën letër
prapë lot mbi emrin tënd kam derdhur
si çdo herë tjetër.

Prapë i kam puthë fjalët shkronjë për shkronjë
prapë nuk i kam mbyllë sytë
prapë nuk guxoj, sepse sa herë e bëj
më del përpara imazhi yt.

E jo se s'dua të të shoh, jo se nuk po ma vret shpirtin malli
po druhem se në ëndrra e sipër mund të t'puth
e unë s'dua të t'puth si imazh, po si qenie për së gjalli.

Prandaj edhe sonte
njëjtë si dje, njëjtë si nesër
me sy hapur do ëndërroj të t'puth
njëjtë si çdo natë tjetër
me shpresën se ditën që do guxoj t'i mbyll qepallat
do jesh ti
jo një imazh, jo fjalët në letër.

-Anonim

Zgjedh të dua veten

Në shpirt vajzë, në trup djalë
me hënë në faqe e yll në ballë
nga marsi erdha,
rrugës më bekoi Afërdita
sot unë nderoj atë që më dha shpirtin
vesh fustane, bëj gërsheta dhe këndoj lavde e ode.

Përqafoj veten në pranim
nuk dëgjoj pastorë a deputetë,
që vetëm dinë urrejtnen,
vetë ekzistenca ime është revoltë
që bërtet pa ngritur zërin
dhe për ta kjo është çmenduri.


-Aurora

Ajo

Kur flokët e saj shkëlqejnë n'diell
ma shumë se vetë dielli,
Kur buzët e saja janë ma t'ëmblla
se vetë sheqeri,
Kur çdo melodi e çdo kange s'është
ma e mirë se zani saj,
Kur sytë e saj ngjyrë jete m'fusin
n'dhe për s'gjalli,
Kur prekja e saj gjithmonë m'bën
m'u ndje sikur bota
nuk m'duhet ma,
Kur m'shikon ajo
çdo herë unë rilindi.

Tash p'e kuptoj që me dasht
s'është mëkat
Dashnia jem s'është mëkat
Dashnia jem është dashni.

-Ez













KLUEEA

KLUEEA

Në emër të dashurisë

A të ka ndodhur të sakrifikosh
në emër të dashurisë
pa e prekur,
pa ju afruar
por të sakrifikosh vetëm për një shikim?

Të ka ndodhur të vuash
në emër të dashurisë?
pa e ditur “përse?”
pa e ditur “se si?”
por vetëm kur e shikon e kupton,
dhe veten e lëshon.

Të ka ndodhur të largohesh
në emër të dashurisë?

Për ta haruar, për të ndryshuar
dhe mbi të gjitha, për të mos u lënduar.

A të ka ndodhur të thuash “Të Dua”,
në emër të dashurisë?

Për të larguar çdo vuajtje,
për të mos vuajtur për çdo ndryshim,
dhe për të mos ndryshuar atë çfarë ndjen.

-Beta

Kujtimi i fundit

Nëse do ta kuptoje se sa të dua,
do ta gjeje mënyrën të jetoje me mua.

Aromën tënde të ëmbël
do e pranoja të depërtonte në mua.

Shikimin tënd të vrazhdë
do e gdhendja te çdokush që dua.

Zëri yt, jehonë,
do jetë melodi e këtij momenti.

Dhe nën pikat e këtij shiu rrëmbyes
do lëmë gjurmët e hapave
që do hedhim larg njëri-tjetrit.

-Beta

Shkelma

Ushqema shpirtin me lot,
hidhma pertoke
edhe gjuaje
me shkelma.

Mbyte me duart e tua të pista
atë shpirt që pastër e gjete,
pastër e le
shkelma.

Kafsho dorën që ta ushqe zembrën me pafajësi
e fajet e tua i mori të gjitha mbi pëllëmbë.
Kafsho të njëjtën dorë, dorën që mbajti tënden
kur askush tjetër s'ta zgjati të veten
kafshoje, haje me dhëmbë.

Shkelmo katër muret
në të cilat arratisë mendjen
kur kishte nevojë për pak qetësi.

Shkelma dashurinë
që kam ndaj teje si njeri
nese vetëm ashtu të merr gjumi natën,
e ndjen të njëjtën lumturi.

Shkelma, se t'u duk sikur unë shkela tënden
kur s'thashë gjë tjetër veçse një të vërtetë
shkelma
fajin tënd lëre mbi pëllëmbën time përjetë.

-Anonim

Zgjidh

Në kryqëzim tani ti je,
tre rrugë përpara ke,
kë të zgjedhësh, jo se di,
këtë në dorë e ke ti.

Në rrugën e parë është trishtimi,
të vazhdosh të qash me gjithë mundimin,
të qash për atë njeri
që të la me dy fëmijë.

Rruga e dytë
shumë e shkurtër është,
disa hapa përshkro
drejt vdekjes, sigurt ti shko.

Por kujdes dhe mendo...!!!

Në rrugën e tretë janë dy fëmijë,
po të presin plot dashuri,
ata ty të duan shumë
ata pa ty jo nuk marrin frymë.

Ti për ata duhet të jetosh,
ti për ata s'duhet të derdhësh lot,
ti për ata duhet të buzëqeshësh,
sa më të bukur tua bësh jetën.

-Ervis Elezaj

Prekje e mallkuar e butë

Askush, as dielli nuk më ngroh më
që prej ditës kur ma zaptove zemrën
e ma shtrove me retë e tua gri të dashurisë.

Era e ftohtë e dimrit
ndihet si një fllad i freskët vere
që kur fortuna jote më ceku lëkurën
dhe ashpërsoi prekjen time.

Prekje e mallkuar dikur e butë
si tymi që del nga goja jote e hidhur me aq ëmbëlsi
duke e bërë cigaren të duket e shëndetshme.

E njëjta prekje e mallkuar e butë
që të bëri të mos ndjesh më
asnjë prekje tjetër njëlloj.

-Anonim

Fjalë shpirti

Në sytë e tu sotshoh dritën e diellit që po shuhet
një re e re formohet, nxjerrë nga ti fjalë që thonë se s'thuhet
fjalë që shpirti brenda i ka mbajtur këtu e s'di sa vjet
fjalë që mendove se bashkë me ty u deshën me vdekë.

Deshe ti, desha unë
ti njerëz t'ndryshëm çdo vit
e unë ty çdo vit e më shumë.

E çdo vit e më shumë po bëhet e vështirë
kur kujtoj se s'më kujton as emrin
s'di pse filloj ndihem e pështirë.

Vallëzon në mendjen time kur as gjumi
s'më bën shoqëri me natën.
Shoqërinë e vetme t'cilën së fundmi e kam dashtë
se veç në atë shoqëri ndonjëherë kam mujt me t'pasë.

-Anonim

Sekonda

Është ora 9.57 dhe kam frikë se nuk do
të më dërgosh mesazhnë 12.
Çfarë të bëj nëse nuk më dërgon mesazh në 12?
Të pres? deri nesër?
mendova se kishe vdekur
si të marr hua
ca kohë?
Si të t'marr borxh
për dy sekonda
nuk kam qene kurrë kaq shpejt
kjo është arsyeja pse unë kam nevojë
të kthehem pas në kohë dhe të marrim
frymë dhetë mendoj
për dy sekonda
nuk mund të vazhdoj të kërkoj
më shumë sekonda
ato gjithmonë disi shndërrohen në
minuta, muaj,
pse nuk mund të ndalem aq sa
dy sekonda të ndyra
të një jete
dhe për dy sekonda të ndyra
pse nuk e mban mend
se unë jam e jotja dhe ti je e imja
dhe do të të kap
edhe nëse nuk kushtoj vëmendje
qoftë edhe për një sekondë
më vjen keq
nuk dua të të thyej
nuk dua të të bej
të besosh se nuk kemi një "ne"

jo për një sekondë
(siç bëj unë
për atë që ndihet si dekada)
Unë dua vetëm pak besim
nuk dua të të bëj të qash
nuk dua të të lëndo
nuk dua të të jap
Mendime të dyta
apo edhe një dyshim
dhe nuk doja të të merrja
të mirëqenë
(madje edhe për një sekondë)
jo ty dhe jo kohën
dëshiroj vetëm për një sekondë
do të kujtohesh se jam e jotja
që ti të jesh e imja

-Anja Simeoni

(Pa titull)

Kur u bëmë emigrantë
humba lirinë time.
U linda gocë e madhe dhe me guxim.

Hajde zogu mos na turpëro
ne që jemi lodhur aq për ty
ne duartë të pronarëve që kemi jetu.
por unë nga Athina deri në Tiranë
jam lezbike dhe dylber
një shqiptar që frikë të sjellë.

O më falni që ju gabova
dhe turpërova familjen time
o sa më donit para se gjëja mendjen time

-Drita Aliu.

ËSO

M'kishe pritë dhe një herë t'shpejtë,
orën me zbritë me pa për ty?
Tregomë, akrepi i vogël si ka flejt,
e t'madhin them se tani e kam msu'.
Rendjen e kamve t'mija ia kam shtu'.

E di, s'ke qenë me m'pa ato herë,
dhimbjen tate timen kur ma ke bo'.
As truri im s'ka ditë me m'dhënë shenjë
si, hija jote mbi timen ka zënë tokë.
Haptas, qenien tate ai lartëson,
u spërkat mendimeve lavde.
Rendjen e kamve sinkronizon!

Pritmë, të lutem, dhe unë të kuptoj,
erën tate t'mirë kush ma vodhi?
Rrëmbimin ta stisi, shpuzë ta soll!
Syrin e Botës time njish me taten,
e përdrodhi si llastik e matanë e hodhi!

Me vete i kam mbajtur ngado,
vargjet e tua t'buk'ra monodike.

KAM PLAS' KUR TI VETË I BRAKTISJE,
QË T'MBAJE ËSO-N E NJI KËNGE FATALISTE!

-Anisa Sali

Errësirë

U linda bashkë me errësirën
a ndoshta errësira lindi me mua.

Rinia më shkoi duarsh,
pa u ndjerë, pa e gëzuar,
veç heshtje, vetmi e ndrydhje
dhe befas, ja, u plaka.

Ditët e mia të gjata
i kaloj duke folur me veten.
I hakërrehem para pasqyrës,
me urrejtje, inat, tërbim,
i them më të fundit fjalë
të lodhurit, shpirtit tim.

Shigjeta të helmatisura,
të lustruara për merak,
vetes i ngul çdo ditë
gjatë monologut
çmendurak.

Fjalët e mia të hidhura
pikojnë dhembje e gjak.
Godasin pa mëshirë
helmojnë pak nga pak.

Dhe trupi fiket, zbehet
s'ka më asnjë qëllim
errësira zbret ngadalë
në thellësinë e shpirtit tim.

-Anonim

Në kërkim...

Ka ditë që endem rrugëve
në kërkim të një shikimi
ku mos të ketë mëri, urrejtje.

Vetëm dy sy kureshtarë,
të gatshëm për të vështruar.

Ditë të tjera endem maleve
në kërkim të një zëri
që nervat t'm'i paqtojë.

Vetëm një zë të ëmbël
që rreth meje të jehojë

Ditët e mbetura endem deteve
dhe sdi as vetë ç'kërkoj.
Ndoshta një yll deti,
a ndoshta një sirenë,
që shpirtin të ma pushtojë.

-Anisa Sali

Orgji shekullore

E kaloj natën duke e parë kur flen
edhe hëna e netëve të ftohta
të dimrit nuk e ka
zbehtësinë e saj.

Duket si një foshnje
që në mënyrë të pavetëdijshme
rrezaton joshjen e saj
duke mrekulluar krijesat e natës.

Sa e dua vdekjen në ato çaste.
Sa shumë do ta dashuroj atë kur të vdesë.
Ajo do të jetë foshnja ime e vdekur
tiparet prej sukubusi të egërsuar
që merr gjatë çasteve të ekstazës,
do të ëmbëlsohen nga balsamet
magjike të vdekjes.

Në ftohtësinë therrëse të trupit të saj
do të gjej prekjen e pshndjellëse të vdekjes
trupin tim do ta përshkojë një ortek
impulsesh seksuale.

Nuk do të ketë më as kohë as hapësirë
por vetëm aromë kundërmuese seksi
përshtjellim klithmash ç'njerëzore
melodi violinash të ç'akorduara
dritë verbuese kristalesh hënore

UNË, TI, AJO
ORGJI SHEKULLORE.

-Xheni Karaj

Trishtim

I pafuari mik futet në dhomë
dhe fillon të luajë instrumentet misterioze
tinguj të ç'akorduar përshkojnë muret elastike
hapin dyer të panjohura
forma pa trajtë, marrin jetë dhe
pëshpërisin fjalë të çuditshme.

Akrepat e orës i bien daulles së vdekjes
kompozitori orkestron himnin e marrëzisë.

-Xheni Karaj

Tani jam Davidi

Tani jam legjendar.
Një gladiator pa emër, me kokën e luanit
shpërdredhur në dorë
më gjetën mbuluar me pluhurin e bodrumit
...dhe më fotografuan në sallë konferencash.

Tani jam Davidi.
Një formë e shëmtuar mermeri, vjedhur
nga minierat afër Firences
ma lëmuan trupin e zhveshur,
flokët kaçurrela m'i bënë me tryelë
...dhe më braktisën në sheshin e pallatit të vjetër.

Më thonë Statuja e Lirisë tani.

Me sy të ashpër, me një dorë të lodhur
të ngritur nga 122 vjet
më fshehën, për të më mbrojtur
...dhe më ndriçuan, që të më shohin miliona vetë.

U gdhiva si diktator tani...
Një burrë shteti që shikon me arrogancë
simpoziume shkencore ndërkombëtare më kushtuan
...pastaj më shkelën, pshurrosën, më hodhën në shesh.

Mbijetova edhe sot si Hero Kombëtar...
Pasi më vranë, kockat m'i zhdukën e
me to bënë suvenire jeniçerësh
më pikasën në dokumenta, për të më lartësuar
...dhe më hipën në një kalë për të "mbretëruar".

Tani ndihem si ajo gjethja në mermerin
e lashtë që ta dhurova.

Gdhendur aty, buzë kishës së parë, nga një fëmijë
ndihem si poshtërimi i mijëra vjetëve,
...si vetmia e miliona fllesheve fotografike!

Mermer i mijëra prekjeve nga të panjohur, ndihem tani...
Si guri i pështymave të urrejtjes,
pështyma që formojnë epsh të ftohtë
...që nuk djeg askë.

Më zbulo, të lutem, tani jam vetvetja...
Ma hiq pluhurin, më ço në shesh,
më lartëso e më braktis atje për 500 vjet
...pastaj eja sërish, më hidh përtokë aq sa të më thyhen format e
bukura!

Më tërhiq zvarrë, më poshtëro, se atë ndjej tani...
ndama trupin e zhveshur në publik
pluhur miliona kokrrizash, më bëj
...po kur të gjithë të kenë ikur, TI mos ik.

-Kristi Pinderi

Jashtë kutisë

Pa fjalë do pranoja,
në mes shiut, të më lagë
do dilja nga kuti e kartonit
...që më mbron poshtë strehës.

Dal nga ajo kuti, nëse do
të plevitosem
lakuriq të turpërohem
...pse jo?

Të dal më mirë,
ftohtë është
edhe poshtë strehës
...së paragjykimeve të tua!

Do dal, do guxoj, do mbështillem pastaj
me trupin e pemës
kartoni, thua
...do më mungojë?

Mund të përgjërohem
para këmbëve të tua
edhe këtë mund ta bëj
... se mes shiut e teje do duhet të zgjedh!

Apo të qëndroj
në kutinë që kohës i reziston
lakuriqësinë ma fshehtë
...nga sytë e tu të verbër?

Prit, prit edhe pak
le të bëjmë një pakt
të dy mirë të ndihemi
...si thua?

Kutinë mund ta hedh, të dal
pemën mos ta shtrëngoj
ta injoroj
...rrugën ta kapërcej!

Shiu le të bjerë
Unë le të bëhem qull
Do dilje pastaj ti nga kutia jote
...vallë!!

-Kristi Pinderi

Drejt asgjëkundit

Nuk e di që mund të më gozhdosh
në një stacion treni.

Me gjatësinë e qerpikëve të tu, duke matur
hapësirën mes binarëve
duke pështyrë pastaj inat, kur
dikush verbon shikimin.

Drejt Teje.

Nuk e di që mund të më helmosh
në një stacion treni.

Kur duke të të përfytyruar
në hollin e pritjes
qesharak do bëhem sa herë dikush
me sy si ti, të zbresë.

Drejt Meje.

Nuk e di që mund të më zgjosh
në një stacion treni.

Kur gjumi të më ketë mundur,
e një tingull të shpërthejë
zemrën ta trondisë, gabimisht.

Teksa një tjetër vjen Drejt Meje.
Ti akoma nuk e di se pastaj
mund të më bësh budalla
në një stacion treni...

...duke më përplasur me xhaketa
te zhubrosura fatkeqësh
që si unë, rendin drejt ëndrrës!
Apo, drejt një tjetër, si TY.
Ti mund të më shurdhosh
në një stacion binarësh, gjithmonë...

Kur frekuenca 10 mijë Hertz
e zërit tënd të përfytyruar!

...të më afrojë te pika 1 miliard centimetrit larg teje,
e të përplaset sërish.

Drejt Meje.

Ti akoma nuk e di se mund të më s
hndërrosh në një barbon
në një stacion treni.

Duke pritur dikë që qindarkat i flakë
në zemrën time, hapur buzë kryqëzimeve
me shigjetat e kuqe.

Drejt Teje.

Nuk e dija, se ti më mëson
në një stacion treni.

Se udhëtojmë në binare ëndrrash
...duke përfytyruar fundin

Drejt Asgjëkundit.

-Kristi Pinderi

Violina e artë

Të isha violina e artë
botës t'i luaja akordet e zërit tënd
kur thotë “zhduku, po deshe”.

Pastaj një pasqyrë të bëhesha,
të të zhvishja ndriçimin e syve
kur thoje “Të dua”.

“Mos u bëj patetik”, do përgjigjeshe!

I rrituri në shtëpinë e drurit, të isha
majë malit me dëborë, përballë oxhakut,
të lexoja ç'kujtime do shkruaja me gotën e verës në dorë
të futesha nën qimet e ulkonjës sy bojëqielli.

Rrotull shtëpisë tënde të dëgjoja...
...zemër më fal...

“Sa plak që je”, do më thoje!

Pastaj të vrapoja si dhelpër,
drejt shtëpisë prej druri nën dëborën e qytetit tënd,
të shkruaja me hapat e bardhë: “Mos e bëj, o plak! Po gabon”...

Të dridhesha si një stilolaps pa dorë,
në fletën e zhubrosur të ditëve me ty
të shkruaja pa gabime “shpirt, më mungon”...
“Më lodhe, për Zotin”, do ma plasje në fytyrë!
të bëhesha korrier virtual
në qiej të fluturoja
me energjinë e netëve kur flije në shpatullën time...
pastaj të kthehesha ky që jam
përballë teje!

Të të shikoja dhe njëherë duke qeshur...
“Fluturo, fluturo”...
të bëhesha forca e temperaturës nën zero,
akull që ngrin lotin tënd,
nga faqja të rrëshkisja drejt buzës së poshtme...
të vishesha xhandar me shpatë!
në daljen e belbëzimeve të tua...
të vrisja tej e tej fjalët budallaqe që më thua çdo sekondë
“Ti them gjithmonë, e nuk i vret në kohë”, do ma ktheje!

-Anonim

Ç 'të të them më parë, gjysh...

As veten,
as mua nuk do më njihje dot,
nga t'ia nis...?!

Xhaxhi i akulloreve 10 lekëshe
nuk vjen me poshtë shtëpisë,
si të dielat kur të zgjoja me një frymë
Ku ka shkuar vallë...?!

E mban mend turizmin tonë?
Sapo e çukisje dy herë bastunin fisnik,
kamarierët drejt te vraponin...

E mbaj poshtë krevatit valixhen tënde të vjetër...
ku ke "varrosur" ëndrrat, poezitë dhe
tre romanet e pabotuara
tre herë e kam hapur! Tre herë e kam mbyllur me frikë...!

Ç'të të them, gjysh?
E mban mend Ramizin e vuajtur, me zemër të madhe,
që të donte aq shumë?!

Sa shumë e kam kërkuar atë njeri...
të kuptoja pse të donte e pse e doje aq shumë!
e ta pyesja sikur të isha ti "Si je Ramiz?
Si i ke nga shtëpia?"

Kanë humbur gjysh, e kanë harruar...
përveç valixhes tënde, që ende ndodhet aty
e më frikëson...!
dhe stolit tonë buzë liqenit!

E mban mend atë stol, gjyshi im babaxhan...?
kur tërbohej gruaja jote, e kur tërbohej edhe nëna ime
te ai stol uleshim ne të dy... dhe flisnim për bletët, liqenin
dhe për atë poetin që na ngacmonte nënockën...

Pse nuk jetuam dot më gjatë bashkë të dy,
o njeri i mirë...?!
Te ai stoli buzë mjelmave...
do kishim bërë shpikje të mëdha...
Ç'të të them më parë...tani?
Që më mungon...?!

Apo që mjellmat e bukura që shikonim,
nuk janë më...?
Të të them që jot bijë, ime më,
se ku dreqin e ka harruar bastunin tënd fisnik,
gjyshi im?

Nuk ta them dot këtë hidhësi...!
Të të them që akulloret nuk i shesin më
burrat babaxhanë me kapele të bardhë në kokë,
po makineritë akull të ftohta...?

Ramizin, gjysh, nuk e kam takuar...Të jetë ende gjallë?
po nëse është gjallë do doja ta puthja e t'i thoja: mos u mërzit.

Mos u mërzit më nga regjimet, o plak i mirë...
tani, as gjyshen nuk e kam më, gjysh, gjyshi im...
kur malli më gërryen, e mendoj me ty,
dhe ju kam zili!

-Kristi Pinderi

Uji i ftohtë i dushit ma përshkoi lëkurën e kokës dhe trupin.

Nuk ishte temperatura e tij e ulët ajo që ma bëri mishin kokrra, por kujtimi që m'u rikthye befapast pas 1 dekadë...krimbi i djegur gjatë eksperimentit në orën e lëndës së Fizikës 7.

Kujtova zërin e mësueses..

- Me thjerrra optike nënkuptojmë mjedisin optik të kufizuar nga dy sipërfaqe dhe që ka indeks të thyerjes të ndryshëm nga rrethi; thjerrrat konvergjente mund të konvergojnë rrezet në një pikë. Tani do dalim në oborr dhe do ta ilustrojmë.

Pasi të gjithë zbritëm, mësuesja filloi të gërrmonte me vendosmëri, gati dhunshëm dheun për disa minuta, derisa u kthye me një krimb toke të mbështjellë rreth një lapsi karboni.

Ja, ky krimbi, që është krijesë hermafrodite meqë ra fjala, as femër dhe as mashkull domethënë, sot do t'i shërbejë eksperimentit tonë -tha ajo duke nënqeshur.

Pasi e vendosi krimbin mbi një letër të bardhë, i drejtoi lentin, e cila mblodhi rrezet e dritës në një vijë të drejtë mbi trupin e tij që nisi të digjej. Nuk e di nëse ishin fjalët që dëgjova apo aroma e krimbit të djegur, por sa herë e kujtoj atë episod më pushtojnë s humë ndjenja.

U ktheva në shtëpi atë ditë dhe u kërkova prindërve të më sillnin një lupë zmadhuese kur të ktheheshin nga puna, duke shpresuar që rrezet e Diellit do të zgjasnin derisa ata të ktheheshin. Ashtu ndodhi.

U drejtova te cepi më i ndriçuar i dhomës dhe e drejtova lupën mbi lëkurën e parakrahut që filloi të digjej.

Ajo shenjë më kujton edhe sot se si në atë moment, brenda mureve të dhomës sime që prej vitesh dëgjonin dënesat e mia të fshehta, unë isha krimbi i eksperimentit dhe dora që mbante lupën ishte e gjithë bota, që me dhunë dhe pa mëshirë tentonte të më nxirrte nga vrimat e ndërgjegjes së rënduar, ku prej kohësh gërmoja për të mbijetuar, me qëllimin e vetëm për të më parë teksa digjesha.

Me kohën kam arritur ta lehtësoj ndërgjegjen time. Duke u rritur, kuptova që dashuria është ndjesia që tejkalon neverinë. Edhe atë ndaj vetes. Sot dashuroj me të gjitha energjitë që kam. Për mua sot lentet janë thjesht lente dhe teoritë e fizikës mjaft interesante për t'u studiuar.

-Nini D

Trishtim

Për at' Zot.

Më dhemb mungesa jote.
Sa ngadalë po kalojnë ditët e harrimit tënd.
Dua që koha të ecë më shpejtë
e trishtimi të jetë shkrirë me të renë
e të jetë shpërbërë.

Dua ta bëj check kalendarin.
Dua ta harroj dashurinë për ty,
por kujtimi yt çdo herë
më sillet i ngrohtë dhe i ëmbël.
Dua t'i harroj rrethanat.
Gjërat që ndodhin.

Dua t'i harroj shtetet, kufijtë, karantinat
që prej njëra-tjetrës na shkulën
tamponat, fluturimet, trenat, vaksinat, distancën
dua dhe unë ta shkul veten prej teje.
Jam bërë e dobët për ty.

S'dua të di nëse të mungoj
e nëse ka arritur deri te ti fantazma ime,
a qan kur zgjohesh nga një ëndërr me mua?
A të sillem dhe unë e ngrohtë dhe dashamirëse pas një mbrëmje të
bukur me miqtë e tu?
A të kujtohen format e trupit tim në lëndën e anatomisë?
dhe skicat e reja...

A të vijnë në mendje planet e papërfunduara të projekteve artistike?
A më ke futur sërish në ndonjë zarf me xixa, të ngjitur, të mbyllur,
plot fjalë përshkruese dhe shumë trishtim
a ke hequr dorë nga të gjitha?

Zot.

Sa dhemb dashuria.
Në gjithë tragjeditë të gjej ty,
dhe madhështinë e magjinë e jetës.

Nëse jam e aftë të ndjej kaq shumë
gjërat duhet të kenë një thellësi papërceptueshmërisht të madhe
që me ligjet e tyre t'i zotërojnë të gjitha.

-Sherebel

(Pa titull)

Kjo poezi e shkruar keq, e lënë përgjysëm,
Njëjtë si etapat e jetës sime, të harruara
Njëjtë si ky udhëtim në kohë.
Ku trupi nuk ka formë.
As mendja.

Por vetëm dashuria.
Ka kuptimin e të asgjësë,
por njëkohësisht e të gjithë qenies sime.
Formën e pashkruar, e pamerituar.
Të një vetes sime, në ndërtim e sipër.

Ej, kujdes. Këtu punohet!

-David Hardy

(Pa titull)

Do vallëzohj si kurrë më parë me vetminë time,
në mes të kaq shumë njerëzve diku
përhumbur në Metalurgjik të Elbasanit.

Do hedh valle për të gjithë njerëzit që kam humbur,
për faktin që i lanë hapësirë ndonjëherë
dikujt tjetër, e shumë pak vetes.

Sot do vallzohj me veten dhe dhimbjen time që ka zënë rrënjë që
prej moshës 14 vjeçare,
ku fillova të rritem me ciklin dhe epshin
mishtor të burrave.

Sot, do hedh valle për dashuritë që nuk zgjaten,
por plot me iluzione dhe marrëzi momenti,
Kujtime, momente, çaste të përmbledhura
në shumë vite.

Unë kam qenë gjithmonë para vetes
dhe ndaj jam ende këtu,
në mes të këtyre njerëzve që kanë harruar çfarë
është të heqësh maskën e realitetit
dhe të vendosësh maskën e dashurisë.

-David Hardy

Marrja e shpisë

Kur thonjtë e dorës tem t'vogël janë mbush
me dhe t'u lujt "tezesh" n'mahallë
Kur dollapat janë mbush me kukullat e mia
të bleme te "Shitoret e Kinezve" te Qafa
E kur fustanin e synetisë e kam mbajt vesh 2 muj ditë rresht,
Nuk jam kanë veç fëmijë i vogël, jam kanë marrja e shpisë.

Kur ent' i kam la me shumë vullnet
E kur zani jem s'asht kanë si i djemve t'tjerë
E n'mahallë kur çik-o-djalë m'kanë thirrë
Nuk jam kanë veç fëmijë i vogël, jam kanë marrja e shpisë.

Kur shoqnia jem asht' kanë veç me çika
E ecja jem s'asht' kanë fort burrnore
E as kur me sha nuk kam dijt'.
Nuk jam kanë veç fëmijë i vogël, jam kanë marrja e shpisë.

Kur krejt shkolla "pederr" më ka thirrë
E kur jam depilu për herë të parë
Kur për çika s'kam fol me moshatarë
S'jam kanë veç adoleshent, jam kanë marrja e shpisë.

Kur një djalë për herë t'parë e kam puth
Kur ereksion prej një mashkulli kam pasë
E kur në za kam kajt t'u ju lut perenisë me m'shëru
S'jam kanë veç adoleshent, jam kanë marrja e shpisë.

Kur kamerat e televizioneve në paradë t'krenarisë m'kanë fokusin
E kur krejt akraballaku e kanë pa
S'jam kanë ma gzimi i familjes, jam kanë marrja e shpisë.

Kur veten e kam pranë si homoseksual
E krenar jam ndje
Kur ftyra m'asht gjakos veç për këtë fakt
S'jam kanë ma sugari i fisit, jam kanë marrja e shpisë

Kur t'shpisë e kanë kuptu që gruaja të cilën edhe në ninulla ma kanë
përmend
Asht' burrë, e të njëjtën lumtuni ma jep
E kur botës i kam kallxu sa krenar me veten jam
S'jam kanë ma i tyne, jam kanë marrja e shpisë.

Prej që jam ba me dijt'
Jam kanë marrja e shpisë.
Edhe sot jam,
Marrja e shpisë, pa shpi.

-Agon Rexhepi

LIBERARISM

ALIANCA
LGBT









POEZI QUEER ZINE

Realizuar nga:

Aleanca LGBT & Dylberizm

Redaktoi disa nga poezitë:

Arbër Selmani

Dizajni grafik dhe ilustrimet:

Arrita Katona



Co-funded by the
European Union



This project is co-funded
by the French Development
Agency (AFD)



ALEANCA LGBTI





